

K Ë R K E S Ë

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË RRETHI GJYQËSOR TË SHKODRËS

KËRKUESI: Zamir Golemi i biri i Syris dhe i Rregjinësi, i datëlindjes 1965, lindur dhe banues në Shkodër.

OBJEKTI:

1. Shpalljen të vdekur të shtetasës Diana Zef Golemi (Dema) më datën 16 tetor 1998.
2. Ndryshimin e vendimit gjyqësor nr.117, datë 13.1.1998 të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe lënien e fëmijës Gledi Zamir Golemi për rritje dhe edukim.
3. Marrjen e masës së sigurimit, lënien e fëmijës deri në përfundim të gjykimit kërkuesit për rritje dhe edukim.

Baza ligjore: Neni 375 e vijues i Kodit të Procedurës Civile, neni 98 i Kodit të Familjes dhe neni 202 i Kodit të Procedurës Civile.

Me vendimin nr.117, datë 13.1.1998 të Gjykatës së Rrethit Shkodër është vendosur zgjidhja e martesës mes meje dhe të quajturës Diana Golemi, ku ndër të tjera është vendosur që fëmija ynë i quajtur Gledi Golemi t'i lihet ish-bashkëshortes sime për rritje dhe edukim. Për këtë vendim unë kam marrë dijeni tepër vonë dhe nuk kam patur mundësi ta ankimoj. Sot kanë ndryshuar rrethanat, pasi e quajtura Diana Golemi (ish-bashkëshortja) nuk jeton më.

Në këto rrethana fillimisht si person i interesuar kërkoj që të shpallet vdekja e saj dhe më pas të ndryshohet vendimi gjyqësor duke m'u lënë mua si baba, fëmija Gledi Golemi. Faktin e vdekjes së të ndjeres Diana Golemi e provoj së pari nga një fletë gazete "CUNEO E PROVINCA" të datës 17 tetor 1998, ku jepet lajmi i vdekjes së dy persoanve Giovanni Marcese 52 vjeç dhe të shoqes Diana Golemi 35 vjeç nga një aksident automobilistik, lajm i cili shoqërohet edhe me fotografitë e tyre përkatëse. Ky fakt provohet edhe me një vërtetim të kryeplakut të lagjes ku ajo ka banuar dhe nga thëniet e dëshmitarëve të cilët do t'i paraqes në gjykim.

Sa më sipër, si person i interesuar kërkoj që të bëhet shpallja si e vdekur e të quajturës Diana Zef Golemi. Meqë procedura e këtij gjykimi zgjat mbi 6 muaj, kërkoj nga gjykata që menjëherë të marrë masën e sigurimit të lënies së fëmijës Gledi Zamir Golemi mua (babait) për rritje dhe edukim, deri në përfundimin e plotë të gjykimit.

Bashkëngjitur me padinë paraqes fletën origjinale të gazetës, të përkthyer dhe të noterizuar - si prova kryesore, si dhe mjaft prova shkresore të tjera që provojnë kërkesën time.

KËRKUESI
Zamir Golemi